



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bujar Kuçi	08.07.2026	20.07.2026	2026/0456

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 03.07.2026, OE “KOSOVA MOTORS GROUP ” S H.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0456, kundër, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE OE "AGS Corporation dhe Auto Kacandolli"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-ne-Ritender” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11147-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur,

Lloji i kontratës: Furnizim,

Vlera e parashikuar e kontratës: 243,000.00 €.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2026/0317 i dt:15.05.2026. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 - Qëllimi; Neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo-Diskriminimi; Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve; Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Të nderuar, duke mënjanuar përsëritjet e panevojshme të deklaratave nga ankesa e parë e bërë në OSHP e cila ankesë qe e bazuar nga OSHP, ne tentojmë të japim argumentet tona nga vetëm nga momenti kur lënda është kthyer në rivlerësim ashtu siç OSHP ka dhënë urdhër. Me datë 19.06.2026, AK shpall njoftimin mbi vendimin dhe letrat standarde dhe aty kuptuam se AK e ka rekomanduar të njëjtin OE për dhënie të kontratës. Ne kërkuam çasje në DT për arsye të verifikimit të dokumenteve për çështje të katalogut i cili prejardhjen e ka nga vet OE i rekomanduar për kontratë dhe për këtë është vërtetua edhe nga eksperti shqyrtues pranë OSHP-së dhe paneli shqyrtues poashtu. Nga AK na është bërë e ditur se janë në dispozicion dy (2) dokumente të cilat AK i ka pranuar nga dilleri maqedonas i cili e ka autorizuar operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë. Ne i kemi marrë nga një kopje të këtyre dokumenteve në fjalë dhe shihet se ato janë të lëshuara nga i njëjti diller maqedonas i cili pretendon se katalogu është nga prodhuesi mirëpo ne kemi konstatuar se katalogu nuk qe nga prodhuesi por i bërë nga vet operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet tenderik dhe me krijimin e dokumentit në fjalë nga vet OE kjo shpie drejt shkeljës së Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të DT pika 9.1 & 9.2- Kërkesa 2: Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilin është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara. Vlen të potencohet se gjatë çasjes, AK ka deklaruar se nuk mund të ipen shkresat elektronike sepse konsiderohen konfidenciale dhe rastin në fjalë AK bënë shkelje të Nenit 10 konkretisht pika 3 dhe 4 sepse nuk është mundësuar çasja e rregullt siç LPP garanton dhe nuk ka arsye se përse të cilësohen këto dokumente konfidenciale. Për fund: Ne deklarojmë se dilleri maqedonas bashkarisht me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë kanë përgaditur dhe lëshuar deklarata në favor të tyre dhe i kanë përshtat në atë mënyrë siç atyre i konvenon. Ne deklarojmë përsëri se nuk ka katalog të ndonjë prodhuesi që nuk e ka llogon zyrtare në katalogjet të cilat lëshohen globalisht për të gjithë pa dallim me dizajn zyrtar të prodhuesit ndërsa në katalogun të cilin OE e ka ngarkuar në e-prokurimi shihet haptazi se është i krijuar nga vet operatori ekonomik dhe kjo e bënë këtë OE të papërgjegjshëm dhe njëkohësisht AK duke mbrojtjur vazhdimisht pa të drejtë këto pretendime të këtij OE në fjalë shpie drejt shkeljës së Nenit 1, Nenit 7 dhe Nenit 59 të LPP-së përfshirë poashtu edhe atë Neni 60 - Kriteret për dhënien e Kontratës

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë & teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
---	-----------------	---	---------------------------------------

		Kërkesa 1 Garancion nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit mbi garancion i cili duhet te jetë prej minimum 24 muaj nga data e pranimit finale te furnizimeve.	Dëshmi 1 Deklarate nga prodhuesi c distributori i autorizuar i prodhuesit p garancion minimum 24 muaj.
--	--	---	--

		Kërkesa 2 Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilën është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.	Dëshmi 2 Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilën është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.
--	--	--	---

		Kërkesa 3 OE është i obliguar ta beje servisimi montimin e pjesëve nën garancion brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo ma te largët se 15 kilometra nga Flota Operative bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar. OE i jepet mundësia qe te lidhe kontrate me ndonjë servisë i cili gjendet brenda rrezes (15km).	Dëshmi 3 OE duhet te sjelle Deklarat Lokacioni i servisit (adresa) , Flota Op Lokacioni i OE. Po qesë OE ka objektir servisit me qira duhet te prezantohet marrëveshja mes operatoreve. Marrë duhet te jete e noterizuar.
--	--	---	---

		Kerkesa 4-OE eshte e obliguar te sjelle Deklarate me shkrim per plotesim te kerkesave te AK Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun programin për pjesë rezerv) për modelin e autobartses ne fjalë , po ashtu kompania fituse është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njejtit të pajisen me çertifikata.	Deshmi 4-Kerkesa 4-OE eshte e obligu sjelle Deklarate me shkrim te nenshkr vulosur per plotesim te kerkesave te Kompania fituese është e obliguar që momentin e nënshkrimit të kontratës furnizon me Paisje për diagnostifik kompjuterik dhe CD (katalogun proç për pjesë rezerv) për modelin e auto ne fjalë , po ashtu kompania fituse është obliguar që të bëjë trajnimin e së pak mekanikëve të autoritetit kontraktue njejtit të pajisen me çertifikata.
--	--	--	---

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj specififikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendosë specififikim teknik që favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shumë operatorë ekonomik.

SPECIFIKACIONET TEKNIKE për Autobartëse(merimangë)me plato lëvizëse hidraulike + kran		SASIA	MODELI DHE SPECIFIKACIONET ME TË CILIN OFERTONI (OBLIGATIVE)
		1	
1	Lloji i ngjyresë : e bardhë		
2	Fuqia e motorit : min 324 PS		
3	Klasa e emitimit të gazrave : min Euro 6		
4	Kapaciteti i ulësve : min1+1		
6	Sistemi i frenimit: min ABS		
7	Sistemi i drejtimit : Servo Hidraulik-Timoni në anën e majt.		
8	Karburanti: Diesel		
9			

	Tërheqja 4x2		
10	Nr. i Akseve 2		
11	Tahografi elektrik me disk fleta 24 orëshe		
12	Pesha totale e lejuar min 18000kg		
Kran Hidraulik			
13	Pozicioni I instalimit:Pas kabinës,para platformës		
14	Kapaciteti ngritës në 5 metra min 2.65 t		
15	Rrotullim min 360°,me sistem hidraulik		
16	Stabilizatorë Hidraulikë, me zgjatje anësore deri në 5.6 m		
Dimensionet-Platforma			
17	Çikriku hidraulik:min 5t		
18	Materiali:Çelik me trajtim kundër korrozionit		
19	Kapaciteti I ngarkesës:min 7.5 t		
20	Gjatësia e platos (m): min 6.3		
21	Gjerësia e platos (m): min 2,35		

Garancioni i autobartëses duhet të jetë garancion i plotë **24** muaj, në çmimin e autobartësesë duhet të përfshihen edhe servisimet e rregullta (vaji, filterat-set si dhe frenat)brenda periudhës garantuese.

Autobartësja duhet të jetë e re me vit të prodhimit identik me vitin e urdhërbljes. Paisjet standarde minimale; ,drita për mjegull,drita rotative mbi kabinë(komplet gjerësia e kabinës),paisjet për përforcim të ngarkesës,dy drita mbrapa në kabinë për ndriqim të ngarkesës.Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me : "Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin për pjesë rezerv)" për modelin e autobartses ne fjalë , po ashtu kompania fituse është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njejtit të pajisen me çertifikata.

Obligative autobartësja duhet të jetë e prodhuar me standard Evropiane .

Pjesët kryesore të automjetit(motorri,shasia dhe kabina duhet të jenë nga i njëjti prodhues).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"KOSOVA MOTORS GROUP" S.H.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender"** me numër të prokurimit: **"214/30400-25-11147-1-1-1"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

3.	Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; Auto Kaçandolli SH.P.K.	OE i ka plotësuar të gjitha kriteret administrative dhe Teknike dhe rekomandohet për kontratë. AK, sipas vendimit të OSHP-se me numer 2026/0317 të datës 11/06/2026 ka bërë verifikimin e katalogut me datë 15-16/06/2026 sipas rekomandimit të ekspertit dhe përgjigja e distributorit të autorizuar është si vijon: Ne gjithashtu konfirmojmë se katalogu i paraqitur, specifikimet e automjetit dhe oferta janë origjinale dhe janë gjeneruar direkt përmes sistemit zyrtar të konfigurimit të Mercedes-Benz. Shfaqja e emrit Auto Kaçandolli dhe përfaqësuesit përgjegjës të shitjeve, z. Dardan Qorri, në
----	---	--

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur"

8

		dokumentet e specifikimeve është një veçori standarde e sistemit Mercedes-Benz. Çdo shitës i autorizuar pajiset me një llogari unike përdoruesi që përmban informacionin e kompanisë së shitësit dhe detajet e punonjësit përgjegjës të autorizuar për të përgatitur konfigurimet dhe ofertat e automjeteve. Si pasojë, kur gjenerohet një dokument specifikimi, sistemi identifikon automatikisht shitësin e autorizuar dhe përdoruesin përgjegjës që krijoi dokumentin. Prandaj, prania e këtyre detajeve konfirmon vërtetësinë dhe origjinën e dokumentit. Format i dokumentit të specifikimit është i standardizuar dhe identik për të gjithë shitësit e autorizuar të Mercedes-Benz, ndërsa informacioni i shitësit dhe përdoruesit shfaqet automatikisht nga sistemi dhe shërben vetëm si identifikim i shitësit të autorizuar që e lëshon. Per komisionin e vlerësimit përgjigja është e qartë dhe e arsyeshme Andaj OE ka plotësuar të gjitha kriteret dhe rekomandohet për dhenie
--	--	--

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES
Tenderi i përgjigjshëm me çmimin me të lire
 Sipas Nenit 60.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Radhë	Lënda / grupi: FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender	Çmimi total i ofertës (me TVSH)
1.	Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; Auto Kaçandolli SH.P.K.,	233,985.60

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr.	Grupi:						
1	FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender						
	<table border="1"> <tr> <th>Emri i tenderuesit të suksesshëm</th> <th>Kodi postar</th> <th>Adresa</th> </tr> <tr> <td>Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; Auto Kaçandolli SH.P.K.,</td> <td>Dardania BL.1 Hy.3</td> <td>Dardania BL.1 Hy.3</td> </tr> </table>	Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa	Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; Auto Kaçandolli SH.P.K.,	Dardania BL.1 Hy.3	Dardania BL.1 Hy.3
Emri i tenderuesit të suksesshëm	Kodi postar	Adresa					
Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; Auto Kaçandolli SH.P.K.,	Dardania BL.1 Hy.3	Dardania BL.1 Hy.3					

DEKLARATË

Per kete aktivitet jane pranuar 4 (kater) oferta. Komisioni konstaton qe oferta e përgjigjshme " Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; Auto Kaçandolli SH.P.K " ka plotësuar kriteret ekonomike dhe administrative dhe ka çmimin me të ulet, rekomandohet për dhenie.

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE
 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:
 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur"

7

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues është pale me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-se

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**

Eksperti shqyrtues në pajtim me legjislacionin në fuqi ka analizuar pretendimin ankimor të ngritur nga OE ankues dhe vlerëson se OE ankues në këtë ankesë, ka paraqitur vetëm një pretendim ankimor që ka të bëjë me OE të rekomanduar.

Ky pretendim në këtë ankesë lidhet me pretendimin nr.1 për OE të rekomanduar, që Operatori Ekonomik ankues e kishte në ankesën nr.317/2026.

Lidhur me këtë pretendim ankimor, që ka të bëjë me **katalogun e prodhuesit**, eksperti shqyrtues vlerëson se kjo çështje është trajtuar tashmë në ekspertizën dhe Vendimin e OSHP-së nr. 317/2026. Në atë rast, eksperti kishte konstatuar se dokumenti i dorëzuar nuk mund të konsiderohej katalog i prodhuesit në kuptimin e kërkesës së dosjes së tenderit, mirëpo njëkohësisht kishte vlerësuar se, në pajtim me nenin 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 002/2024 për sqarimin e tenderëve gjatë vlerësimit, kjo mangësi mund të sqarohet gjatë fazës së **rivlerësimit** përmes kërimit të informatave sqaruese, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës. Për këtë arsye ishte rekomanduar kthimi i lëndës në rivlerësim.

Nga dokumentacioni i ofruar si në ankesën e OE ankues, po ashtu edhe në procesverbalin e rivlerësimit të ofertave, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka zbatuar Vendimin e OSHP-së nr. 317/2026, duke e kthyer lëndën në rivlerësim dhe duke kërkuar sqarime shtesë lidhur me katalogun e dorëzuar. Në përgjigjen e datës

15.06.2026, distributori i autorizuar ka konfirmuar se dokumenti (**katalogu**) i paraqitur është **gjeneruar drejtpërdrejt nga sistemi zyrtar i konfigurimit të Mercedes-Benz**, dhe se specifikimet dhe oferta janë origjinale, si dhe ka sqaruar se paraqitja e emrit të shitësit të autorizuar dhe përfaqësuesit përgjegjës është funksionalitet standard i sistemit dhe shërben vetëm për identifikimin e shitësit të autorizuar që e **ka gjeneruar katalogun**. (Dëshmia):



Mak Autostar dooel | Industrijska 2 | 1000 Skopje

MAK AUTO STAR
General Distributor of Daimler Truck AG
for Mercedes-Benz Trucks in
Republic of North Macedonia and Kosovo
T +389 2 258 00 00
F +389 2 258 04 01

STATEMENT

We hereby confirm that Auto Kaçandolli is an authorized dealer of Mercedes-Benz and Daimler Trucks vehicles in Kosovo.

We further confirm that the submitted catalog, vehicle specifications, and offer are original and have been generated directly through the official Mercedes-Benz configuration system.

The appearance of the name Auto Kaçandolli and the responsible sales representative Mr. Dardan Qorri in the specification documents is a standard feature of the Mercedes-Benz system. Each authorized dealer is provided with a unique user account containing the dealer's company information and the details of the responsible employee authorized to prepare vehicle configurations and offers. Consequently, when a specification document is generated, the system automatically identifies the authorized dealer and the responsible user who created the document.

Therefore, the presence of these details confirms the authenticity and origin of the document. The format of the specification document is standardized and identical for all authorized Mercedes-Benz dealers, while the dealer and user information is automatically displayed by the system and serves solely as identification of the issuing authorized dealer.

Accordingly, we fully support and stand behind the catalog, the vehicle specifications, the information provided, and the offer submitted by Auto Kaçandolli.

Kind regards,



16.06.2026

Mak Autostar | Industrijska 2 | 1000 Skopje, Republic of North Macedonia | T +389 2 258 00 00 | F +389 2 258 04 01 | www.mercedes-benz.com.mk
Komercijalna Banka - Skopje, Bank account: 300000000662546 | Tutunska Banka - Skopje, Bank account: 210054121960121 | EDB MK 4030000382893

 and Mercedes-Benz are registered trademarks of Mercedes-Benz Group AG



Pra është sqaruar se katalogu është nga sistemi i Prodhuesit, por të dhënat e shitësit të autorizuar, shfaqen në katalog për shkak të sistemit që e ka kompania **Mercedes-Benz**.

Rrjedhimisht, eksperti vlerëson se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me

udhëzimet e dhëna në Vendimin e OSHP-së nr. 317/2026, duke administruar sqarimet e nevojshme dhe duke eliminuar paqartësitë që kishin ekzistuar lidhur me origjinën e katalogut. Në këto rrethana, konstatohet se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me vendimin e OSHP-së dhe me dispozitat e legjislacionit të prokurimit publik lidhur me këtë çështje.

Për rrjedhojë, edhe pse pretendimi ankimor vlerësohet pjesërisht i bazuar në kuptimin që çështja kishte kërkuar sqarim, ky sqarim është siguruar gjatë rivlerësimit në zbatim të Vendimit të OSHP-së nr. 317/2026. Si rezultat, eksperti vlerëson se ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftim Vendimi i Autoritetit Kontraktues të datës 19.06.2026, duhet të mbetet në fuqi.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa Njoftim Vendimi i Autoritetit Kontraktues të datës 19.06.2026, duhet të mbetet në fuqi.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**", lidhur me aktivitetin e prokurimit **"FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender"** me numër të prokurimit: **"214/30400-25-11147-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**

Bujar Kuçi

